




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-2224/23 datë: 20.01.2023



Npi – 01/41 datë: 25.01.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 25.01.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 25.01.2023 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Sanije Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, znj.Genta Mehmeti, asistente e Kryesuesit. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20.12.2022,
2. Draft- Rregulllore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, (pas diskutimit publik)
3. Raporti vjetor financiar i Komunës së Shtimes për vitin 2022,
4. Propozim-Vendim për ndarjen 100 € për Nënënat-Lehona për vitin 2023.
5. Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2026,
6. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF-së për vitin 2023,

Kryesuesi, z.Andan Ademi; Pasi që është mbledhja e parë, unë ju përshëndeti dhe ju uroj të gjithëve një vit të mbar për vitin 2023. Kuorumin e kemi dhe po vazhdojmë. Hapi diskutimin për rendin e ditës.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20.12.2022

Kryesuesi, zandan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 25.11.2022.**

Pika 2

Draft- Rregulllore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, zandan Ademi; Për këtë pikë fjalën ja dha Bujar Feratit nga ZKF.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përshëndetje, Diskutimi publik sipas vendimit të Kuvendit ka përfunduar, me datën 16.01.2023, kemi mbajtur takim me qytetarë, pjesëmarrës nuk ka pasur shumë, dhe nuk ka pas propozime konkrete. Rregullorja është e njëjta ju ftoj që t'i rekomandoni Kuvendit për aprovim.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, pyetje për ZKF-në – Kërkesa e KRM “Pastërtia” Njësia në Shtime, a do të shkojë e veçantë apo në kuadër të DSHP-së. Dhe me na dhënë pak sqarime për tatimin në pronë,

e dimë që takimet është duke i mbajtur Ministria përkatëse, si qëndrojimë ne si Komunë, apo a ka ndonjë ndryshim?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Në rregulloren qe kemi hartuar përmban gjitha elementet e gjitha drejtive sa i përket gjobave dhe tarifave. Për kërkesën e KRM “Pastërtia” Njësia në Shtime do ta shohim në Kuvend se a do të shkojë si e veçantë apo në kuadër të DSHP-së. Kjo rregullore e Taksave nuk ka të bëjë me normat tatimore ajo është tjetër dhe te Tatimi në Pronë nuk kemi Rregullore por Vendim për normat tatimore, ku ne e kemi aprovuar në vitin 2022, dhe ka shkuar në Departamentin e Agjensionit Tatimor.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me ZKF-në, që mos të japim rekomandim, propozojë që të diskutohet në Kuvend. Te normat tatimore e kuptojë që kemi shkuar në minimum, por ne si subjekt nuk jemi të kënaqur, sepse vlerësimet po bëhen të larta.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, unë propozojë që kërkesën e KRM “Pastërtia” Njësia në Shtime me e drejtuar si të veçantë.

z.Përparim Ramusa; Pajtohem me Kadriun, por për sa i përket tatimeve që duhet paguar, edhe pagat nuk janë ngritur. Pajtohem që të diskutojmë në Kuvend.

Kryesuesi, z.Andan Ademi; Mendoj se më mirë është me bë një rekomandim, pa marrë parasysh se çfarë do të jetë ai.

znj.Adelina Beqaj; Nuk na keni dhënë një informatë për menaxhimin mbeturinave.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandojë Kuvendit, miratimin e Rregullores për Taksë, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, me vërejtjen që Kërkesa e K.R.M “Pastërtia” Njësia në Shtime, për ngritjen e tarifave për shërbime të trajtohet e veçantë në Kuvend.**

Pika 3

Raporti vjetor finanziar i Komunës së Shtimes për vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën për këtë pikë ja dha Bujar Feratit nga ZKF.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Raporti finanziar është obligim ligjor për ne, për të raportuar në Kuvend. Ne e kemi përgatitur Raportin Financiar për vitin 2022. Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë, besoj e keni lexuar. Unë do të vazhdojë që ta lexoj Raportin në pika kryesore (shih dokumentin). Ju ftojë që ta aprovoni, dhe nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Pyetje për Idajetin a duhet me u votua Raportin?

z.Idajet Rexhepi, zyrtar i Kuvendit: Po duhet me e votuar.

z.Përparim Ramusa; Unë propozojë që ky raport mos me u votua në Kuvend, sepse unë mendoj se ky raport nuk e meriton me u votua në Kuvend.

z.Kadri Emini; Sa i përket raportit ne u informuan së është shpenzuar 75.31%. Unë mendojë se buxheti është shpenzuar nuk mundemi me ndryshuar dhe propozojë që ti rekomandojmë Kuvendit që ta aprovojë, sepse punët janë kryer, ndërsa pagesat janë bërë kohëve të fundit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Edhe unë po ndërlidhem me Kadriun sepse punët kanë filluar më herët dhe pagesat janë bërë së fundmi për ku janë kryer punët nuk mundë ta ndryshojmë, sa i përket kualitetit të punës përgjegjësinë e kanë menaxherët e kontratave. Unë propozojë që ti rekomandojë Kuvendit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Ne jemi barazuar në të gjitha kategoritë, përveç te pagat me një shumë rrëth 2777 euro, por unë do të them se ky problem është teknik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mendojë se shpenzimi i buxhetit me 75.31% është i kënaqshëm.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, (Bazuar në nenin 48.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kryesuesi e shfrytëzon të drejtën e votës shtesë “Për” nëse votimi mbetet i barabartë) Kryesuesi Konstaton se Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Raporti vjetor finanziar i Komunës së Shtimes për vitin 2022.**

Pika 4

Propozim-Vendim për ndarjen 100 € për Nënët-Lehona për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Në vitin 2022, i kemi pasur 100 euro për Nënët Lehona. Unë propozojë që për vitin 2023 të rritet në 200 euro.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë kam menduar që ta bëjmë këtë vendim për një vit, dhe e kemi ndarë buxhetin dhe nuk e dimë sa lindje i kemi brenda vitiit nëse shohim që ka buxhet të mjaftueshëm atëherë do ta rishikojmë vendimin.

znj.Adelina Beqaj; Unë i qëndrojë këtij propozimi, sepse ju është dashtë me bërë analizë para se me pru këtu.

z.Lumni Amrushi; Po lidhem te kjo pikë unë kam paralajmëruar, ndoshta është më mirë me ngritë këtë shumë për nënët Lehona. Unë atëherë nuk kam këmbëngul sepse ka mundë të duket si konflikt interesit për mua, ne si kuvendar jemi të interesuar me ngrit këtë shumë edhe pse ne nuk e kemi votuar buxhetin por ju është dashur me analizuar.

z.Përparim Ramusa; E përkrahu propozimin e Adelinës dhe Lumit që ti rekomandojmë Kuvendit që kjo shumë të jetë për nënët lehonë 200 euro për çdo fëmijë të lindur. Edhe pse e di që propozimi ka qenë i LVV-së në vitin 2021, mirëpo edhe ne e kemi përkrahur.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Te viti 2023 kemi edhe disa pagesa të pa kryera për vitin 2022. Në rishikim të buxhetit unë do ta sjell përsëri në Kuvend.

z.Lumni Amrushi; Mirë që po bëhet kjo strategji, shpresojë se do të kryhet më herët ne vitin 2024 të fillojmë me krejt në rregull.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Është mirë me qenë edhe drejtori me na dhënë sqarime për planin e drejtorisë dhe me na e dhënë statistikat, e jo me dal të pasaktë.

z.Përparim Ramusa; Unë po e shohë vullnetin e juaj për ngritjen, por ti si kryesues merre një obligim me diskutu me drejtorët deri në mbledhjen e Kuvendit.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, që të ketë parasysh çmimet 100 € dhe ngritjen në 200€ për nënët Lehona për ç'do lindje të fëmiut në vitin 2023, për banorët e Komunës së Shtimes, me arsyetimin që në mbledhjen e Kuvendit më datën 27.01.2023, drejtori i DSHMS-së të jep sqarime plotësuese.**

Pika 5

Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Nuk kam vërejtje te Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave por kam vërejtje për mos prezencën e drejtorit në mbledhje për me na e dhënë sqarimin e nevojshëm.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sqaroi, se ne i kemi njoftuar drejtorët zyrtarisht. Unë kam biseduar me Kryetarin për këtë punë.

z.Përparim Ramusa; Unë nuk jam për me diskutua pasi nuk e kemi drejtorin ose dikënd nga kjo drejtori në mbledhje.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, që kjo pikë të diskutohet gjërësisht në Kuvend, me kërkesën që në mbledhjen e Kuvendit më 27.01.2023, të jetë drejtori prezent dhe të japë sqarimet e nevojshme.**

Pika 6

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF-së për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Te ora e takimeve të komitetit ne jemi që të jetë në ora 9 apo në ora 10.

z.Përparim Ramusa; Unë jam për me qenë në ora 09:00h, por nuk do të thotë që të jetë ashtu. Mendojë se formalisht është mirë me qenë në ora 09:00h.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Vendimin për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPF-së për vitin 2023, sipas Propozim – Vendimit Npi-01/09, në ora 9:00h.**

Pasi diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:22h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF

Adnan Ademi